

PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

Pozita: Teknik (mirëmbajtës i objektit)

Departamenti i Administratës

Divizioni i Shërbimeve Administrative dhe Transportit

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të shërbimeve administrative dhe transportit

Grada: 10

Përmbledhja e Detyrave dhe Përgjegjësi:

- Kujdeset për mirëmbajtjen e përgjithshme të ndërtesës në hapësirat e brendshme si dhe ato të jashtme;
- Riparon, mirëmban dhe instalon elemente të sistemit elektrik, hidro sistemit, ngrohjes qendrore, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
- Kujdeset për mbajtjen e kontakteve me autoritetet/kompanitë e specializuara teknike në rast të intervenimeve dhe asiston me rastin e riparimeve;
- Kujdeset për të lëshuar në punë dhe ndërprerë sistemet e ngrohjes qendrore, ftohjes/klimave, gjeneratorët elektrik, ashensorët dhe pajisje tjera sipas nevojës;
- Mban evidencë rreth servisimit të pajisjeve (gjeneratorë, ashensorë, çiler ftohës, etj.) si dhe furnizimit me derivateve të naftës të cilat janë të deponuara në rezervuarët e këtyre pajisjeve;
- Përgatit specifikimet teknike për furnizim me produkte dhe materiale të nevojshme për mirëmbajtje të objektit;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e hapësirës së jashtme – oborrit, kopshtit, etj.;
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës që vjen nga mbikëqyrësi direkt.

Kriteret dhe kualifikimet:

- Të posedoj diplomë të shkollës së mesme – drejtimi teknik (ndërtimtari, makineri, elektro, hidro) ose të ngjashme;
- Të posedoj përvojë pune profesionale së paku 3 vite;
- Aftësi për leximin e projekteve, skicave, referencave të produkteve dhe materialeve;
- Aftësi komunikuese dhe të jetë i gatshëm për punë në grup;

- Preferohet aftësi e përdorimi të kompjuterit, së paku të programeve (Word, Excel, Internet) për raportim, etj.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga organizata kompetente;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 janar 2019**.
- Aplikimi mund të bëhet on-line (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr:22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**